



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 11 shtator 2019

Numri i lëndës: 2016-28

S.H.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 shtator 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 22 shtator 2016.
2. Me shkresën e datës 23 shtatorit 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, 9 shtator 2017 dhe 17 tetor 2017, Paneli ka kërkuar nga kjo dhe nga ankuesit e tjerë që të ofronin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre.

4. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve duke ofruar informacion shtesë në lidhje me dy raste, duke përfshirë edhe këtë.
5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli iu ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shëfës së Misionit (ShM-së), EULEX-it Kosovë, duke e ftuar atë të parashtrojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se me datën 26 janar 2018.
6. Vërejtjet e ShM-së u morën më 16 tetor 2018, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
7. Më 28 mars 2019, Paneli ka shpallur lëndën të pranueshme (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-03-28%20Admissibility%20Decision%202016-28-a-fw.pdf>) në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (tani e tutje Konventa). Në atë vendim, Paneli ka bërë një numër pyetjesh palëve dhe ka kërkuar nga ta që të ofrojnë përgjigjen e tyre deri më 20 maj 2019. Pyetjet ishin si më poshtë:
 - i. Për Misionin:
 - a. Pse ankuesi nuk ishte i informuar nga Misioni për ekzistencën, karakterin dhe rrjedhën e hetimit?
 - b. Pas lirit të të gjithë të pandehurve në këtë rast si të pafajshëm, a janë bërë përpjekje të tjera hetimore për të identifikuar dhe ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për zhdukjen e të afërmit të ankueses? Nëse jo, pse? A është bërë ndonjë përpjekje, në veçanti që të kërkohen të merren prova të tjera?
 - c. Në bazë të njohurive të Misionit, a janë autoritetet e Kosovës ende duke hetuar këtë rast? Nëse po, në cilën fazë gjendet? A është duke e monitoruar këtë lëndë Misioni?
 - d. A ka ndërmarrë Misioni ndonjë hap (para ose që nga 14 qershori 2018) në ushtrimin e mandatit (të ri) të tij për të siguruar që ky rast të zbardhet nga autoritetet vendore?
 - e. Aty ku bëhet e qartë për Misionin që autoritetet vendore nuk janë në gjendje apo nuk dëshirojnë të hetojnë një çështje penale, cilat janë kompetecat dhe mjetet e Misionit (nëse ka) për të kërkuar që të sigurohet se është vendosur drejtësia dhe viktimat të kenë qasje në një zgjidhje juridike lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre?
 - f. A ka bërë shkelje apo ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës?

- ii. Për ankuesen:
- a. A jeni përfshirë në procedurën kundër dhjetë të pandehurve? Nëse po, a keni pasur ndonjë kontakt me Misionin e EULEX-it apo përfaqësuesit e tij në atë kontekst?
 - b. Pas lirimit të këtyre të pandehurve, a keni pasur ndonjë kontakt të mëtejshëm me EULEX-in Kosovë në lidhje me këtë çështje?
 - c. A ka bërë shkelje apo ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
 - d. Cilat janë pasojat personale, financiare dhe emocionale – që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?
8. Më 14 maj 2019, ankuesja i ka kërkuar Panelit që ta zgjas afatin, në bazë të konsideratave personale përkatëse. Paneli e miratoi atë kërkesë dhe i dha ankuesit afat deri më 20 qershor 2019 që të paraqiste ndonjë parashtresë shtesë në lidhje me meritën e lëndës dhe pyetjet e Panelit (shih, më lart, paragrafi 7). Parashtresat shtesë të ankuesit ishin pranuar më 20 qershor 2019.
9. Më 17 maj 2019, ShM-ja ka dërguar përgjigjet dhe parashtresat e saj në Panel.

II. PËRBËRJA E PANELIT

10. Pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të saj, anëtari në largim është zëvendësuar nga znj. Autio me emërimin e saj në Panel në përputhje me rregulloren 14 të rregullores së punës së Panelit. Për të siguruar një njohje të plotë të çështjes, znj. Autio është njohur me dosjen e plotë të lëndës, përfshirë atë lidhur me pranueshmërisë së saj, dhe për këtë arsye është plotësisht në gjendje të marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj lënde.

III. IDENTITETI DHE QËNDRIMI I ANKUESIT

11. Ankuesi kërkoi që të mos zbulohej identiteti i tij. Duke marrë në konsideratë çështjen, posaçërisht natyrën e pretendimeve që bëhen, Paneli është i bindur që kërkesa duhet të pranohet.
12. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta familjare midis viktimës së drejtpërdrejtë dhe ankuesit, Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të pretenduara dhe, si i tillë, si viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

IV. FAKTET

13. Më 15 mars 1999, rreth orës 11.00, babai i ankuesit kishte dalë nga shtëpia për të shkuar te rrobaqepësi i tij në Mitrovicë. Më vonë ishte parë duke pirë kafe në një kafene në veri të Mitrovicës.
14. Më vonë atë ditë, rreth orës 17.00, ai e kishte marrë me veturë një person të panjohur për në shtëpinë e tij në Zhabar. Ai dyshohej se ishte konfrontuar dhe rrëmbyer rrugës nga Zhabari për në Mitrovicë nga personat që po vozisnin me disa automjete. Këta persona pretendohet se mbanin armë dhe uniforma me emblema të UÇK-së. Ata gjoja se e kishin marrë babanë e ankuesit në drejtim të fshatit Vaganicë. Babai i ankuesit ishte zhdukur atëherë dhe deri më sot fati i tij mbetet i panjohur.
15. Ankuesi ka raportuar zhdukjen e tij në Zyrën Rajonale të OSBE-së në Mitrovicë, në KNKK dhe në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë.
16. Më 16 dhjetor 1999, KNKK-ja ka hapur një kërkesë për ta kërkuar babain e ankuesit.

V. PARASHTRESAT E PALËVE

Ankuesi

17. Siç përmbledhet më lartë, ankuesi pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë duhej të kishte hetuar zhdukjen e të afërmit të tij dhe me faj nuk e ka bërë hetimin në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe të të afërmeve të tij.

Parashtrimet e shefit të Misionit ("ShM") mbi pranueshmërinë

18. Disa nga parashtrirat e bëra nga ShM-ja në kontekstin e pranueshmërisë së kësaj lënde janë të rëndësishme për të vendosur rreth meritave të saj. Prandaj, Paneli do të përshkruajë këtu shkurtimisht disa nga parashtrirat e bëra nga ShM-ja në një fazë të hershme të procedurës.
19. Në letrën e saj të 16 tetorit 2018, ShM-ja ka sqaruar se si pjesë e dorëzimit të lëndëve dhe dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u në EULEX Kosovë gjatë periudhës dhjetor 2008 - mars 2009, një raport i njësisë për personat e zhdukur të Policisë së UNMIK-ut (MPU) që i referohet babait të ankuesit ishte transferuar në EULEX Kosovë.
20. Përveç kësaj, në nëntor 2009, një individ iu ishte drejtuar Njesisë së Hetimit të Krimeve të Luftës të EULEX-it (NjHKL) për të dhënë informacione lidhur me krimet që dyshohet se ishin kryer nga ai dhe individë të tjerë dhe duke përmendur babanë e ankuesit si një prej viktimave të këtyre krimeve. Nga të dhënat e Misionit, del se ankuesi nuk ishte informuar nga Misioni në atë fazë të ekzistencës së lëndës.

21. Në shkurt të vitit 2010, një prokuror i EULEX-it i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) lëshoi një "Vendim për të filluar hetimin" ndaj një individi që kishte siguruar informacione rreth këtyre krimeve nën disa akuza të krimeve të luftës. Pas kësaj, ishte lëshuar një "Vendim mbi zgjerimin e hetimit" për t'i zgjeruar akuzat.
22. Në korrik 2010, ishte lëshuar një "Vendim mbi zgjerimin e hetimit" i dytë ndaj shtatë të dyshuarve për "krime lufte ndaj popullatës civile" dhe "krime lufte ndaj të burgosurve të luftës". Babai i ankuesit ishte përmendur në këtë aktvendim.
23. Emri i babait të ankuesit gjithashtu paraqitet në "Vendimin për fillimin e hetimit" të lëshuar në tetor 2010 dhe i përket krimeve të luftës ndaj popullatës civile dhe krimeve të luftës ndaj të burgosurve të luftës. Në këtë aktvendim, babai i ankuesit ishte përmendur si një prej viktimave që gjoja se ishte vrarë 'në bashkëpunim nga pjesëtarët e UÇK-së' dhe si një nga individët, integriteti trupor dhe shëndeti i të cilit ishte shkelur përmes rrahjeve të përsëritura, të cilat gjoja se ishin kryer nga pjesëtarët e UÇK-së përderisa mbahej në një objekt të UÇK-së në Kleçkë, diku midis mesit të marsit dhe fillimit të prillit 1999.
24. Në gusht 2010, me kërkesë të prokurorit të PSRK-së së EULEX-it, personi që i ishte afruar EULEX-it dhe kishte dhënë informacion në vitin 2009 ishte shpallur 'dëshmitar bashkëpunues' nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë.
25. Në korrik 2011, prokurori i PSRK-së së EULEX-it paraqiti në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë një aktakuzë për "krime lufte ndaj popullatës civile dhe të burgosurve të luftës" ndaj dhjetë (10) të pandehurve. Emri i babait të ankuesit u përmend si viktimë në aktakuzë. Të afërmit e tij u tha se ishin thirrur si palë të dëmtuara gjatë procedurave gjyqësore.
26. Në një datë të pasaktësuar më vonë, procedurat u ndanë në dy grupe të të pandehurve.
27. Në mars 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë në një trup gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjykatës të Kosovës nxori një aktgjykim ndaj grupit të parë të të pandehurve, duke i liruar nga të gjitha akuzat.
28. Në maj 2012, një trup gjykues nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar të Kosovës liroi të pandehurit e tjerë.
29. Pas ankesave të prokurorit të PSRK-së së EULEX-it në nëntor dhe dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës prishi aktgjykimet dhe i ktheu lëndët ndaj dhjetë të pandehurve për rigjykim.
30. Në shkurt 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës nxori një aktvendim për t'i bashkuar lëndët.
31. Në shtator 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës në një trup gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar të Kosovës përsëri liroi të gjithë të pandehurit. Në atë gjykim, emri i babait të ankuesit ishte përmendur përsëri si viktimë. Ky aktgjykim ishte apeluar pa sukses dhe ishte vërtetuar në janar 2016.

32. Në maj 2017, Gjykata Supreme e Kosovës në një trup gjykuesish të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar të Kosovës e refuzoi si të pabazuar një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë të paraqitur nga prokurori në gusht 2016.
33. ShM-ja nuk ishte në gjendje të përcaktonte nëse ankuesi dhe/ose të afërmit e tjerë të viktimës ishin përfshirë në hetimin e kësaj lënde nga EULEX-i Kosovë. ShM-ja ka treguar se ajo nuk ishte në dijeni rreth ndonjë hetimi që është në vazhdim e sipër që lidhej me zhdukjen e babait të ankuesit.
34. Në parashtresat e saj për pranueshmërinë, ShM-ja gjithashtu ka dhënë një përshkrim të hollësishëm të procesit kompleks që është përfshirë në transferimin e lëndëve nga UNMIK-u në Mision dhe punën e përfshirë nga ana e Misionit për rishikimin, organizimin dhe kategorizimin e lëndëve dhe dosjeve të lëndëve.
35. Lidhur me përpjekjet e Misionit për të hetuar rastet e 'zhdukjes me forcë', ShM-ja vuri në dukje se nocioni "zhdukje me forcë" nuk ishte vetvetiu pjesë e kornizës normative përkatëse që është bazë e punës së vet dhe se krime të tilla janë hetuar dhe ndjekur penalisht si raste të krimeve të luftës.

Parashtresat e ShM-së mbi meritat e lëndës

36. ShM-ja i ishte përgjigjur pyetjeve të Panelit (shih, më lart, paragrafi 7) me shkresë të datës 17 maj 2019.
37. Si përgjigje të pyetjes së parë ("Pse ankuesi nuk u informua nga Misioni për ekzistencën, karakterin e përgjithshëm dhe rrjedhën e hetimit?"), ShM-ja tregoi se:

"Aktualisht nuk është në gjendje të përcaktojë nëse dhe në çfarë mase ankuesi ishte i përfshirë ose i informuar për hetimin e kryer nga njësitë e tij kompetente".

Pozicioni i ShM-së është se përderisa nuk është në gjendje të përjashtojë që ankuesi ishte informuar për hetimin, ai as nuk mund të pohojë se nuk ishte ashtu. Më tej ShM-ja fton Panelin të ndryshojë sugjerimin e bërë në vendimin e pranueshmërisë së Panelit që ankuesi nuk ishte informuar rreth hetimit.

38. Paneli e refuzon atë ftesë. Bazuar në të dhënat në dispozicion të Panelit, nuk ka asnjë indikacion që Misioni kishte ndërmarrë ndonjë hap për të informuar ankuesin për ekzistencën, karakterin ose rrjedhën e hetimit. Është përgjegjësi e Misionit, në përmbushje të detyrimeve të tij, të informojë viktimat për shkeljet e të drejtave të njeriut, varësisht në bazë të kompetencave të veta hetimore. Është gjithashtu përgjegjësi e Misionit të sigurojë që të ruaj të dhënat e plota dhe të sakta të këtyre përpjekjeve. Në mungesë të indikacioneve në ato shënime për ndonjë përpjekje për të arritur dhe informuar ankuesin, Paneli nxjerr përfundimin nga kjo se Misioni nuk ka arritur të informojë ankuesin rreth ekzistencës, karakterit ose rrjedhës së hetimit. Kjo më tej adresohet më poshtë.
39. Pyetja e dytë e Panelit ishte si vijon:

"Pas lirim të të gjithë të pandehurve në këtë rast, a ishin bënë përpjekje të tjera hetimore për të identifikuar dhe ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për zhdukjen e të afërmeve të ankuesit? Nëse jo, pse? A ishte bërë ndonjë përpjekje, posaçërisht për të kërkuar për të siguruar dëshmi të tjera?"

40. Si përgjigje, ShM-ja thotë se EULEX-i nuk ka ndërmarrë përpjekje të tjera hetimore pas lirim të të gjithë të pandehurve në lëndët penale. ShM-ja thotë se nën mandatin e atëhershëm të zbatueshëm ishte kompetent vetëm për t'i hetuar "lëndët që ishin në vazhdim e sipër". Për raste të tjera, Misioni pohon se kompetenca e tij mund të filloj vetëm nga "rrethana të jashtëzakonshme" pas një vendimi të përbashkët të EULEX-it dhe autoriteteve kompetente të Kosovës. Për më tepër, ShM-ja bën parashtrësat e mëposhtme:

"Me qëllim të promovimit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë të shtuar nga institucionet kompetente të Kosovës dhe gjithashtu për arsye të efikasitetit, duke filluar nga viti 2014 dhe gjithnjë e më shumë pas ndryshimeve të fundit në "Ligjin mbi Juridiksion" të vitit 2016, EULEX-i zbatoi "një politikë pa lëndë të reja" dhe përqendroi përpjekjet e veta në përfundimin e 'lëndëve në vazhdim e sipër'. Prandaj, në bazë çfarë u përmend më lart dhe duke marrë parasysh përpjekjet e konsiderueshme që ishin investuar tashmë në hetimin e 'rastit Kleçka', duke marrë parasysh rrethanat, Misioni nuk e konsideroi se ishte në gjendje të bënte më shumë sesa që kishte bërë tashmë për të hetuar rastin në fjalë. Për më tepër, duke pasur parasysh që zhdukja e z. [XX] ishte hetuar dhe ndjekur penalisht nga EULEX-i në kuadër të rastit Kleçka', do të ishte e palogjikshme që të bëhej më shumë përpjekje në këtë rast kur kishte lëndë të tjerë që ishin në vazhdim e sipër. Në këtë kuptim, EULEX-i në thelb nuk pajtohet me vlerësimin e Panelit se kishte autoritete ekzekutiv 'të hetoj dhe të vazhdoj të hetoj këtë çështje', pasi kjo mundësi ishte thjesht teorike.

Këto argumente do të adresohen në tërësi më poshtë.

41. Në lidhje me pyetjen e tretë të Panelit ("Sipas dijenisë së Misionit, a janë autoritetet e Kosovës ende duke e hetuar këtë rast? Nëse po, në cilën fazë është? A po e monitoron Misioni këtë rast?), ShM-ja tregoi se nuk është në dijeni rreth ndonjë hetimi në vazhdim e sipër të këtij rasti dhe "fton ankuesin dhe Panelin që t'ia drejtojnë këtë pyetje institucioneve kompetente të Kosovës".
42. Sa i përket pyetjes së katërt të Panelit ("A ka ndërmarrë Misioni ndonjë hap (para ose që nga 14 qershor 2018) në ushtrimin e mandatit të tij (të ri) për të siguruar që ky rast të zbardhet nga autoritetet vendore?"), ShM-ja pohon se mandati aktual i EULEX-it "në asnjë mënyrë nuk i jep të drejtë Misionit të japë këshilla për raste individuale ose të jep autorizim" për "të sigurur" që lëndët janë rastet të zbardhen nga autoritetet vendore'").
43. Pyetja e pestë e Panelit për Misionin ishte kjo:

"Kur bëhet e qartë për Misionin që autoritetet vendore nuk janë në gjendje ose nuk duan të hetojnë një çështje penale, cilat janë kompetencat dhe mjetet e Misionit

(nëse ka) të kërkojnë të sigurojnë që drejtësia është vënë në vend dhe se viktimat kanë qasje në një mjet juridik në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre?”

Duke iu drejtuar kësaj pyetjeje, ShM-ja thotë: si “nën mandatin e tij aktual, Misioni nuk ka kompetencë të kërkojë të sigurojë” që drejtësia të vihet në vend dhe që viktimat të kenë qasje në një mjet juridik në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre’.” Misioni thotë se roli i tij është i kufizuar në mbështetjen e institucioneve të zgjedhura të shtetit ligjor të Kosovës, përmes aktiviteteve të monitorimit dhe funksioneve të kufizuara ekzekutive. Misioni nuk specifikon se cilat janë ato “funksione të kufizuara ekzekutive”. Misioni më pas përshkruan funksionin e tij të monitorimit pa dhënë shumë detaje se çfarë do të thoshte ky mandat, megjithëse tregon se Misioni "siguron vlerësimet dhe gjetjet e tij për institucionet e Kosovës dhe i informon akterë të tjerë përkatës të BE-së në mënyrë që të forcojnë përparimin e Kosovës në rrugën e saj evropiane”.

44. Më në fund, në lidhje me pyetjen nëse Misioni ka shkelur ose kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës, ShM-ja thotë se janë ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm në lidhje me hetimin e këtij rasti dhe tregon për sfidat dhe kompleksitetet e përfshira në hetimin e këtij lloji të rasteve.

Parashtresat e ankuesit në lidhje me bazueshmërinë e lëndës

45. Më 20 qershor 2019, ankuesi paraqiti komente shtesë në përgjigje të parashtresave të ShM-së, të cilat u përcollën për informacion në Mision. Në to, ankuesi specifikon se ai nuk ka pasur kontakte me EULEX-in dhe nuk ka marrë pjesë në procedurat ndaj dhjetë të pandehurve; e as nuk ishte i informuar për rezultatin e këtyre procedurave. Sipas ankuesit, ky dështim nga ana e Misionit për ta informuar atë për ekzistencën dhe rrjedhën e këtyre procedurave është pjesë e shkeljes së të drejtave të tij.
46. Në përgjigje të pyetjes rreth efekteve personale, financiar dhe emocionale – në lidhje me zhdukjen e të afërmit tuaj - ankuesi shpjegoi vështirësinë emocionale të tij dhe të nënës së tij, fakti që nga frika për sigurinë e tij, ai vendosi të largohej nga qyteti në të cilin jetonte dhe duke i shkaktuar kështu vështirësi serioze financiare. Ankuesi gjithashtu beson se zhdukja e babait të tij bëri që shëndetit të nënës së tij, gruas së personit të zhdukur, të përkeqësohej. Gjëja më e vështirë, shtoi ai, ishte të jetonte pa lajme për babanë e tij dhe atë që i ndodhi atij dhe t'i mohojë mundësia për ta varrosur. Ai shton:

“Çfarë i ka bëri keq familja ime ndokujt, dhe tani në moshën 57 vjeç kam ende statusin e një personi të zhvendosur në një qytet tjetër, shtëpinë e marrë, dhe pa të dy prindërit, unë mbeta i bindur që babai im ishte viktimë, gjithashtu si nëna ime në mënyrë indirekte dhe unë drejtpërdrejt viktimë e dëmit anësor të një procesi në të cilin të tjerët morën çdo gjë dhe unë humba gjithçka”.

Më në fund, ankuesi tha:

"Unë bashkëndej me të gjithë ata që u vranë në një luftë të ndyrë në Kosovë ndërsa dëshiroj vetëm drejtësi dhe të gjej eshtrat e babait tim për ta varrosur në një mënyrë paqësore dhe dinjitoze".

47. ShM-ja nuk iu përgjigj atyre parashtrësive.

VI. GJETJET E PANELIT

Mandati ekzekutiv dhe përgjegjësitë e Misionit

48. Veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it në parimin janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave. Prandaj, në parim ato bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K-T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 43, *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23; *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35). Ky është rasti nëse sjellja themelore në fjalë përbëhet nga një akt pozitiv ose një dështim i fajshëm nga ana e Misionit. Shih *Krlić kundër EULEX-it*, 26 gusht 2014, par 25.
49. Paneli tashmë ka pasur rastin të theksojë se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët nga një shtet (shih vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50, *K-T kundër EULEX-it*, cituar më lart, paragrafi 53, krahasoni gjithashtu vendimin e PKDNJ-së në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35).
50. Pritjet e vendosura mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur çështjet komplekse penale duhet të jenë realiste dhe të mos i ngarkojnë EULEX-it një barrë joproportionale që mandati dhe burimet e tij nuk mund të priten t'i përmbushin në mënyrë të arsyeshme (LO kundër EULEX, 2014-32, dhe të gjeturat, 11 nëntor 2015, paragrafët 43 dhe 45, dhe referencat e tij në: Vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09, 2012-12, 20 qershor 2013, para 50; kundër EULEX-it, 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 53, krahasoni gjithashtu vendimin e PKDNJ-së në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35; në rastet 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituar më lart, paragrafi 70-71 Shih gjithashtu Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, paragrafët 35-37; DW, EV, FU, GT, Zlata Veselinovic, HS, IR kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim mbi pranueshmëri, 30 shtator 2015, paragrafët 72-74, shih gjithashtu vendimin e PKDNJ në lëndët 248/09, 25 0/09 dhe 251/09, cituar me lart, par. 70-71). Prandaj, në secilin rast, Paneli duhet të shqyrtojë nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund të kenë dëmtuar kapacitetin e EULEX-it për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv të një rasti. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikojë mangësitë operacionale që nuk

lidhen me sfida konkrete dhe të demonstrueshme. Shih, përsëri, L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 44.

51. Në vlerësimin e kësaj ankese, Paneli ka marrë parasysh vështirësitë e përfshira domosdoshmërisht në hetimin e krimeve të luftës në një shoqëri pas konfliktit si Kosova (shih L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, 11 nëntor 2015, paragrafi 44 dhe referencat e përmendura aty, Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, aplikacioni 4704/04, aktgjykimi i 15 shkurtit 2011, paragrafi 70, vendimi i PKDNj-ja në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, paragrafët 44 dhe 62 e tutje). Megjithatë këto vështirësi nuk duhet të shërbejnë për të maskuar apo justifikuar dështimet hetimore që nuk janë në ndonjë mënyrë kuptimplotë të lidhura me vështirësitë e përmendura. Prandaj, Paneli do të vlerësojë në çdo rast nëse një hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur për EULEX-in do të ishte bërë jopraktik nga arsyet që lidhen me rrethanat pas konfliktit, pavarësisht nga ata që kryejnë hetimin (L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendim dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 44).
52. Veçanërisht relevante në vlerësimin e përgjigjes së Misionit është fakti se aftësia e tij për të përmbushur detyrimet e veta hetimore është ndikuar qifte nga rrethanat e përgjithshme në të cilat ishin kryer krimet dhe nga sjellja e UNMIK-ut pas këtyre krimeve. Krimet e kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur janë pothuajse gjithmonë një sfidë për të hetuar. Sfida shpesh mbetet menjëherë pas një konflikti, sepse dëshmitë mund të shkatërrohen ose të kufizohen dhe gatishmëria ose aftësia e dëshmitarëve për të dhënë informacion mund të reduktohet ndjeshëm në këtë kontekst. Paneli ka marrë në konsideratë këto sfida gjatë marrjes së vlerësimit ndaj përgjigjes së Misionit.
53. Paneli gjithashtu ka marrë parasysh faktin se EULEX-i Kosovë duhej të përballej dhe të trajtojë trashëgiminë hetimore të UNMIK-ut. Duket nga shënimet e kësaj lënde - dhe lëndëve të tjera që janë parashtruar në Panel - se UNMIK-u ka dështuar në shumë aspekte t'i përmbushë detyrimet e veta ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me viktimat e "zhdukjeve të detyruara". Kjo ishte vënë në dukje siç duhej nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut, i cili përcaktoi se UNMIK-u kishte shkelur të drejtat e viktimave në veprime të tilla në disa raste. Është gjithashtu e qartë nga parashtresat e Misionit në këtë lëndë, ku tërheq vëmendjen rreth natyrës së dobët dhe të pamjaftueshme të shumë prej dosjeve të lëndëve që janë transferuar nga UNMIK-u në EULEX në fillim të mandatit të EULEX-it. Evidentimi i duhur, i zellshëm dhe i organizuar i informacionit që ka të bëjë me kryerjen e shkeljeve të tilla serioze të të drejtave është një element i rëndësishëm i mbrojtjes efektive të këtyre të drejtave. Në bazë të natyrës dhe peshës së veprimeve në fjalë, praktikat e ruajtjes së shënimeve nga ana e UNMIK-ut ishin jo të duhura. Paneli nuk do t'ia ngarkoj mangësitë dhe defektet Misionit, që duhet t'i vihen UNMIK-ut. Paneli ka marrë parasysh ato rrethana kur ka bërë vlerësimin e sjelljes së Misionit dhe sfidat me të cilat është përballur.
54. Në çdo rast, në rastet e veçanta të këtij serioziteti, autoritetet hetimore pritet të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi të arsyeshme dhe të investojnë burime në përputhje me domosdoshmërinë dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa asnjë autoritet hetues nuk mund të pritet të zgjidhë të gjitha rastet e paraqitura përpara tij, pritet të veprojë me një kujdes të tillë, shpejtësi dhe efektivitet, duke pasqyruar rëndësinë e çështjes nën hetim (L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor

2015, paragrafët 46 dhe 59, dhe referenca e tyre në GjEDNj: Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, aplikacioni nr.16064 / 90 e tutje, aktgjykimi i 18 shtatorit 2009, paragrafi 191, Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, paragrafi 63).

55. Një angazhim dhe lidhje e rreptë ndaj këtyre standardeve është veçanërisht e rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit që synon të shërbejë si një shembull i angazhimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të ndërtuar në të një ndjenjë përgjegjësie ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave. Çdo standard që është më pak se ai që u përmend më sipër do të rrezikonte të krijonte një ndjenjë të pranimit të mosndëshkimit dhe mosrespektimit të kërkit të drejtësisë dhe llogaridhënies ndaj viktimave (L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 46 dhe referenca në GjEDNj: Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, aplikacioni nr.16064/90 e tutje, aktgjykim i 18 shtatorit 2009, paragrafi 191, Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, aplikacioni 4704/04, aktgjykimi i 15 shkurtit 2011, paragrafi 63); Vendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, para. 80.); Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimet dhe të gjeturat, 19 tetor 2016, par. 37; shih gjithashtu vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lart, par. 80).
56. Sa i përket çështjes së shpejtësisë, Paneli dëshiron të theksojë si më poshtë. Lidhur me detyrimet e tij hetuese, Misioni kërkohet të hetojë dyshimet e besueshme ndaj shkeljeve të drejtave të njeriut me kujdes dhe shpejtësi dhe për të siguruar në të gjitha rastet se reagimi hetimor i Misionit është në përputhje me rëndësinë e çështjes. Në përgjithësi, përgjigja duhet të jetë e tillë që të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave në fjalë. Shih, në përgjithësi, Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 36. Gjithashtu shih Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, Kërkesa nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i 18 shtatorit 2009, par. 191; *Oğur kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 21594/93, aktgjykimi i 20 majit 1999, par. 88; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 24746/94, Aktgjykimi i 4 majit 2001, par. 105-09; *Douglas-Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 56413/00, vendimi i 8 janarit 2002.
57. Kur detyrimi i shtetit ose autoritetit përfshin detyrim për të hetuar, kriteri për shpejtësi duhet të zbatohet në të gjitha fazat dhe aspektet e hetimit: nxitjes së tij, sjelljes së tij dhe kryerjes së tij. Kriteri për shpejtësi është relativ për nga natyra: varet nga rrethanat e secilit rast veç e veç, në veçanti prej sfidave të paraqitura nga rasti, vështirësitë për t'iu qasur dëshmitarëve ose mbledhjes së informacionit. Por sfidat dhe vështirësitë hetimore nuk i arsyetojnë zvarritjet, vonesat apo ngadalësimet e pajustificueshme në kryerjen e detyrave hetimore. Kjo është një deklaratë e së drejtës më të gjerë për procedim pa vonesa të panevojshme, që u garantohej të gjitha palëve në procedurë. Paneli ka theksuar kështu se -

"E drejta për një dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme siç kuptohet sipas nenit 6 (1) të Konventës është hartuar për të mbrojtur" të gjitha palët në procedurat gjyqësore ... ndaj vonesave të tepruara procedurale ... Përveç kësaj, në rastet penale, e drejta është e projektuar në atë mënyrë për të shmangur që personi i akuzuar të mbetet tepër gjatë në gjendje të pasigurisë lidhur me fatin e tij "[...]" (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 57,

citatat janë nga *Stogmuller kundër Austrisë*, aplikacioni nr.1602/62, aktgjykimi i datës 10 nëntor 1969, paragrafi 5).

58. Në një rast të veçantë, në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohës që merret nga autoritetet, janë identifikuar një numër faktorësh si veçanërisht të rëndësishëm, duke përfshirë këto: (1) kompleksiteti i lëndës, (2) sjellja e aplikantit dhe (3) sjellja e administratës kompetente (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 58, dhe referencat e saj për Konig kundër FRG, Aplikacioni nr. 6232/73, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 qershor 1978, paragrafi 99, Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës, Aplikacioni nr. 49017/99, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 17 dhjetorit 2004, paragrafi 45; shih gjithashtu Thomas Rüsche kundër EULEX, 2013-21, 11 janar 2017, paragrafi 59-65). Një hetim i pasojës së vonesave nga palët e përfshira gjithashtu mund të sigurojë dëshmi përkatëse të arsyeshmërisë ose ndryshe të vonesave në proces (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafët 64-66 dhe referencat e cituara).
59. Duhet gjithashtu të theksohet për qëllimet këtu se të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër të drejtat më të rëndësishme prej të gjitha të drejtave themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjes me forcë përbën një shkëlqje të egër të këtyre të drejtave. Kjo reflektohet, *ndër të tjera*, në faktin se tani konsiderohet dhe karakterizohet si një krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specialistëve (Ligji nr. 05/L-053) (Neni 13(1)(i)).
60. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të Misionit në qershor të vitit 2018 dhe implikimet e tyre për qëllimin e këtij rasti trajtohen shkurtimisht më poshtë.

Rastet e "zhdukjes me forcë" në kontekstin e mandatit të Misionit

61. Praktika e zhdukjes me forcë është një nga shkeljet më të egra të të drejtave të njeriut. Ato përfshijnë shkeljen e jo një të drejte, por shumë të drejtave, duke përfshirë në shumë raste, të drejtën për të vërtetën, të drejtën e njohjes si person para ligjit, të drejtën për liri dhe sigurinë e personit dhe të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës dhe trajtimit ose dënimit tjetër të egër, çnjerëzor ose poshtërues, të drejtën për një zgjidhje efektive dhe një sjellje të tillë cenon ose përbën një kërcënim të rëndë për të drejtën e jetës. Shih, p.sh., Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 33; Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me forcë (A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992).
62. Veçanërisht e rëndësishme në këtë kontekst është e drejta e ankuesit për të vërtetën, d.m.th. e drejta e viktimave për të ditur se çfarë ka ndodhur me të afërmit e tyre dhe rrethanat nën të cilat ata janë zhdukur. Më gjerësisht shih EI-Masri kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, aplikacioni nr. 39630/09, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 12 dhjetorit 2012, paragrafët 191-193; Orhan kundër Turqisë, Aplikimi nr. 25656/94, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 18 qershorit 2002, par. 358; Imakayeva kundër Rusisë, Aplikimi nr. 7615/02, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i datës 9 nëntor 2006, paragrafi 164; Velásquez

Rodríguez kundër Honduras, Aktgjykimi i IACtHR i datës 29 korrik 1988, par. 181; Heliodoro Portugal kundër Panama, Aktgjykimi i IACtHR i datës 12 gusht 2008, par. 244; Anzualdo Castro kundër Perusë, Aktgjykimi i IACtHR, i datës 22 shtatorit 2009, par. 116-118; Komenti i Përgjithshëm mbi të Drejtën e të Vërtetës në Marrëdhënien ndaj Zhdukjes së Zbatuar, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme, 2010, në veçanti, par. 1 ('E drejta për të vërtetën në lidhje me zhdukjet me forcë nënkupton të drejtën për të ditur për përparimin dhe rezultatet e një hetimi, fatin ose vendndodhjen e personave të zhdukur, dhe rrethanat e zhdukjeve, dhe identitetin e kryesit (s).'), Dokumenti A / HRC / 16/48; Vendosja e parimeve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut përmes veprimeve për të luftuar mosndëshkimin (E/CN.4/2005/102/Add.1), në veçanti, Parimet 2-4; dhe, gjithashtu, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me forcë, e miratuar 20 Dhjetor 2006, në veçanti, Preambula dhe arti. 24 (2); dhe, për një ilustrim, rasti i Gudiel Alvarez et al. ("Diario Militar") kundër Guatemalës, Aktgjykimi i IACtHR i 20.11.2012; Meritat, riparimet dhe kostot, par. 301 (dhe referencat e cituara).

63. Për gati dy dekada, ankuesja ka jetuar me pasigurinë rreth fatit të babait të tij, se çfarë i ka ndodhur atij dhe në cilat rrethana ai është zhdukur. Vuajtja psikologjike që rezulton nga kjo nuk është vetëm e një shkalle të madhe. Ajo është në vazhdim e sipër. Shih gjithashtu D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për Pranueshmëri, 30 Shtator 2015, para. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 35 dhe 42. Shih gjithashtu, në kontekstin e nenit 3, GjEDNj, *Kurt kundër Turqisë*, vendimi i 25 majit 1998, Raportet e Vendimeve dhe Vendimeve 1998 III, par. 130-34; *Khadzhialiyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 3013/04, aktgjykimi i 6 nëntorit 2008, par. 120-121; *Timurtas kundër Turqisë*, aplikacioni nr. 23531/94, Aktgjykimi i 13 qershorit 2000, para. 95; Rezoluta nr. 828 e 1984, paragrafi 3 (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës); dhe Komentin e Përgjithshëm mbi nenin 17 të Deklaratës, Raportin e Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose zhdukjet e pavullnetshme 2000. Dokumenti E/CN.4/2001/68 (duke iu referuar dhe komentuar nenit 17(1) të Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithëve Personat nga Zhdukja me Forcë).
64. Natyra e vazhdueshme e shkeljes së të drejtave të përfshira në këtë praktikë shpjegon se detyra e autoriteteve kompetente për t'i hetuar këto është një detyrim urgjent dhe i rëndësishëm që mund të lihet mënjanë ose të shtyhet për më vonë vetëm në rrethana të kufizuara.
65. Kur bëhet fjalë për hetimin e rasteve të zhdukjes me forcë, hetimet duhet të fillojnë sa më parë që të jetë e mundur dhe vonesat të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur. Kjo nuk është vetëm për shkak të efektit mbi të afërmit e mbijetuar. Është gjithashtu për shkak se provat do të zhduken ose do të humbasin dhe kujtesa zbehet. Prandaj vonesat në hetime mund të ndikojnë negativisht në mundësinë e një hetimi që përcakton rrethanat në të cilat një person është zhdukur dhe të sjell fajtorët para drejtësisë. Për ilustrimet e zbatimit të kësaj garancie në kontekste të ndryshme, më gjerësisht shih: *Gürtekin dhe të tjerët kundër Qiprosë*, Vendim mbi Papranueshmëri i GjEDNj-së i datës 11 mars 2014; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 7 korrik 2011; *Jaloud kundër Holandës[GC]*, Aplikacioni nr. 47708/08, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 20

nëntor 2011; *Jelić kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 57856/11, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 12 qershor 2014; *B. dhe të Tjerët kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 71593/11, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 18 qershor 2015; *Palić kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 4704/04, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 15 shkurt 2011; *Lejla Fazlić dhe të Tjerët kundër Bosnjës dhe Hercegovinës and 4 të Tjerëve*, Aplikacioni nr. 66758/09, 66762/09, 7965/10, 9149/10 and 12451/10, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 3 qershor 2014; *Mujkanović dhe të Tjerët kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 47063/08 et al., Vendim mbi Papranueshmëri i GjEDNj-së i datës 3 June 2014; *Nježić and Štimac kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 29823/13, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 9 April 2015.

66. Për shkak të efektit të akteve të tilla ndaj të afërmeve të një të zhdukuri, është me rëndësi themelore që ata të përfshihen në hetimin e rasteve të tilla në masën më të madhe të mundshme. Si çështje e ligjit mbi të drejtat e njeriut, nga autoritetet hetuese kërkohet që t'i informoj viktimat e shkeljeve të të drejtave lidhur me rrjedhën e hetimit të tyre. Në fakt, kjo kërkon që ato të balancojnë të drejtën dhe interesin e viktimave për t'u informuar për progresin e hetimit me shkallën e nevojshme të fshehtësisë që një hetim mund të kërkojë me ligj. Duke iu nënshtruar konsideratave të ligjshme të konfidencialitetit dhe sigurisë, viktimat kanë të drejtë të jenë të përfshira dhe të jenë të informuar në mënyrë të mjaftueshme për procesin e hetimit. Përderisa përmbajtja e saktë e asaj që duhet t'u jepet atyre është vështirë të përcaktohet në mënyrë abstrakte, informacioni i dhënë për ata që janë të përfshirë në mënyrë më të drejtpërdrejtë nga hetimi duhet të jetë i tillë që t'u mundësojë atyre të binden se çështja po shqyrtohet siç duhet dhe se të gjitha përpjekjet përkatëse dhe të arsyeshme janë duke u bërë për të përcaktuar fatin e të afërmeve të tyre dhe për të identifikuar ata që janë përgjegjës për të. Më gjerësisht shih *Dešanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, para. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-73; *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, aktgjykimi i 6 prillit 2004, para. 311-314, *Isayeva kundër Ruisisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, aktgjykimi i 24 shkurtit 2005 par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aikacioni nr. 55721/07, 7 korrik 2011, par. 167.
67. Ky detyrim për t'i mbajtur të informuar viktimat në lidhje me përpjekjet hetimore është veçanërisht e rëndësishme në një rast që ka përfshin ndonjë zhdukje me forcë, pasi të afërmit e mbijetuar nuk mund të kenë burim tjetër informacioni lidhur me këtë çështje dhe do të vazhdojnë të jetojnë me shpresën se fati i të afërmeve të tyre një ditë do të sqarohet. Pra kjo përbën një detyrim që autoritetet kompetente hetimore nuk duhet të lejohen që lehtësisht ta lënë anash ose injorojnë.

Rastet e "zhdukjes me forcë" në kontekstin e mandatit të Misionit

68. ShM-ja nuk e konteston që Misioni ishte kompetent për të hetuar këtë rast. Është e qartë nga hapat e ndryshëm të ndërmarrë nga Misioni se ai e konsideronte veten kompetent për të shqyrtuar këtë rast dhe, siç ndodhi, edhe për ta ndërprerë atë. Kjo gjithashtu del nga fakti se ai ka mbajtur në kujdestari dosjen e lëndës në lidhje me këtë rast deri në përfundimin e mandatit ekzekutiv të Misionit.
69. Paneli tashmë ka vendosur që këto lloj rastesh hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv dhe kompetencës hetimore/prokuroriale të Misionit. Shih, p.sh., D.W., E.V., F.U., G.T.,

Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për Pranueshmëri, 30 Shtator 2015; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 Shtator 2015; L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, vendimet dhe të gjeturat, 11 nëntor 2015.

70. Kur akte të tilla janë kryer në kontekstin e një konflikti të armatosur, siç ishte rasti në këtë rast, sjellja në fjalë mund të cilësohet si krim lufte, krim kundër njerëzimit ose krim me bazë etnike, mbi të cilat Misioni kishte kompetencë specifike dhe të qartë juridiksionale nën mandatin e atëhershëm të tij në fuqi. Në përgjithësi shih nenin 3 (d) të veprimit të përbashkët të Këshillit. Shih gjithashtu Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 44-46. Në D.W. e tutje, Paneli në lidhje me këtë çështje ka thënë si në vijim:

“Ka pasur një mundësi shumë reale që këto krime dhe shkeljet shoqëruese të të drejtave të bazoheshin në konsiderata etnike ose fetare duke shkuar më tej në territorin e juridiksionit mbi të cilin Misioni ka kompetencë. Në një mjedis pas konfliktit ku marrëdhëniet etnike dhe fetare mund të jenë ende të tensionuara dhe të brishta, raste të tilla kanë përparësi të dukshme hetimore. Kjo përsëri në bazë të të dhënave nuk duket se është konsideruar relevante për përcaktimin e "rrethanave të jashtëzakonshme" nga ana e Misionit”.

Shih D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par. 83 e tutje, në veçanti par. 85.

71. Hetimi i këtyre rasteve jo vetëm që ishte pjesë e mandatit të Misionit, por ishte një element thelbësor dhe themelor i tij. Në *L.O. kundër EULEX-it*, Paneli theksoi kështu se:

"mund të ketë shumë pak mospajtim në atë se hetimi i fatit të të zhdukurve - pavarësisht nga feja apo përkatësia etnike - duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operativ për EULEX-in si Mision i sundimit të ligjit për të cilin duhet të sigurohet me burime adekuate.

Shih L.O. kundër EULEX-it, rasti nr. 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 47. Rasti aktual do të vlerësohet në bazë të kësaj.

72. Në të kundërtën, në bazë të të dhënave të lëndëve që vijnë në Panel - përfshirë edhe këtë lëndë këtu - është e qartë se EULEX-i ka dështuar në shumë raste t'i trajtojë këto lloje të lëndëve si përparësi hetimore ose të paktën për t'ia kushtuar kohën dhe burimet e nevojshme për të zhvilluar hetime në kohë dhe në mënyrë efektive rreth atyre rasteve. Shih për shembull, Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 34-39; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për Pranueshmëri, 30 shtator 2015, par. 72-76; L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 43-47 dhe 59-65; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, paragrafi 47; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 58, 60, 62-65, 81-82.

73. Konsideratat e mësipërme do të shërbejnë për të vlerësuar përpjekjet e bëra nga Misioni në lidhje me këtë rast dhe nëse ato mund të thuhet se janë në përputhje me mandatin e përgjithshëm të Misionit dhe obligimet ndaj të drejtave të njeriut.

Sjellja e Misionit në lidhje me rastin në fjalë

74. Për arsyet e përshkruara më sipër, Misioni nuk duhet të vlerësohet sipas standardeve të përsosura. Misioni është përballur në atë kohë me një mjedis sfidues të pas konfliktit. Burimet e tij ishin të kufizuara dhe, në disa aspekte, joadekuate ndaj detyrës dhe pritshmërive. Kjo kërkonte që Misioni të bënte zgjedhje dhe t'u jepte përparësi përpjekjeve të caktuara mbi të tjerët. Për më tepër, mënyra në të cilën UNMIK-u kishte bërë përpjekjet e veta "hetuese" dhe transferimin e dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u tek EULEX-i ka komplikuar në masë të madhe punën e këtij të fundit. Si përgjigje, Misioni ka investuar kohë, burime dhe energji në rishikimin e këtyre shënimeve dhe duke u përpjekur t'i kuptonte ato. Në lidhje me këtë përpjekje, Misioni duhet të përshëndetet.
75. Sidoqoftë, këto përpjekje nuk kanë bërë shumë për të mbrojtur dhe garantuar efektivitetin e të drejtave themelore të ankueses dhe bashkëshortit të saj. Paneli ka identifikuar dy mangësi kryesore në sjelljen e Misionit që kanë rezultuar ose kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të parashtruesit të ankesës dhe atë të bashkëshortit të saj:
- i. Dështimi për të hetuar plotësisht dhe me zell çështjen; dhe
 - ii. Dështimi për të përfshirë dhe informuar në mënyrë të mjaftueshme viktimat.

Mos informimi i të afërmeve për viktimën

76. Është vërejtur më lart se nuk ka asnjë indikacion në të dhënat e Misionit se e ka përmbushur detyrimin e tij për të informuar ankuesin për ekzistencën, rrjedhën dhe karakterin e hetimit (shih, paragrafi 38 më lart).
77. Një detyrim i tillë është element thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të viktimave në hetimin e një lënde të tillë. See, e.g., *Desanka and Zoran Stanisic kundër EULEX*, 2012-22, 11 November 2015, para. 66, referring to L.O. kundër EULEX, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, ECtHR Judgment of 6 April 2004, paras. 311-314, *Isayeva kundër Rusisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, GjEDNj Aktgjykimi i datës 24 shkurt 2005 par. 211-214; *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, GjEDNj Aktgjykimi i datës 7 korrik 2011, par. 167.
78. Ky detyrim është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e incidenteve të zhdukjes me forcë kur viktimat vuajnë emocionalisht nga mungesa e informacionit lidhur me fatin e të dashurve të tyre. Shih *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87. Duke theksuar të drejtën e viktimave për të vërtetën në këtë kontekst, *Komenti*

i Përgjithshëm i Grupit të Punës për Zhdukjet me Forcë thotë në lidhje me këtë çështje si në vijim:

“Neni 13 i Deklaratës njih obligimin e shtetit për të hetuar rastet e zhdukjeve me forcë. Paragrafi 4 i nenit 13 specifikon se "gjetjet e një hetimi të tillë duhet të vihen në dispozicion në bazë të kërkesës për të gjithë personat e interesuar, përveçse nëse kjo do të rrezikonte një hetim penal që është duke vazhduar”. Në dritën e zhvillimeve që kanë ndodhur që nga viti 1992, Grupi i Punës konsideron se kufizimi në pjesën e fundit të këtij paragrafi duhet të interpretohet ngushtë. Në të vërtetë, të afërmit e viktimave duhet të lidhen ngushtë me një hetim në rastin e zhdukjes me forcë. Refuzimi për të dhënë informacion është një kufizim e së drejtës për të vërtetën. Një kufizim i tillë duhet të jetë në mënyrë proporcionale me qëllimin e vetëm legjitim: për të shmangur rrezikimin e një hetimi penal në vazhdim. Refuzimi për të siguruar ndonjë informacion ose për të mos komunikuar fare me të afërmit, me fjalë të tjera është një refuzim i plotë, është shkelje e së drejtës për të vërtetën. Sigurimi i informacionit të përgjithshëm mbi çështjet procedurale, siç është fakti që çështja i është dhënë gjykatësit për shqyrtim, është i pamjaftueshëm dhe duhet të konsiderohet shkelje e së drejtës për të vërtetën. Shteti ka për detyrë që çdo person i interesuar të njohë hapat konkrete të ndërmarra për të sqaruar fatin dhe vendndodhjen e personit. Një informacion i tillë duhet të përfshijë hapat e ndërmarrë në bazë të dëshmive të ofruara nga të afërmit ose dëshmitarët e tjerë. Përderisa nevoja për një hetim penal mund të justifikoj kufizimin e bartjes së informacionit të caktuar, duhet të ketë një mjet juridik në legjislacionin vendor që të shqyrtohet një refuzim të tillë për të siguruar informacionin për të gjithë personat e interesuar. Ky rishikim duhet të jetë i disponueshëm në kohën e refuzimit fillestar për të dhënë informacione dhe më pas në mënyrë të rregullt për të siguruar që arsyeja se nevoja, e cila ka qenë ngritur nga autoriteti publik që të refuzojë të komunikojë, mbetet e pranishme”.

Shih Komente të Përgjithshme mbi të Drejtën e së Vërtetës në Marrëdhëniet ndaj Zhdukjes me forcë, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme (2010), Dokumenti A/HRC/16/48, paragrafi 3; Zufe Miladinović kundër EULEX, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; dhe, gjithashtu, lënda *I. e Río Negro Massacres kundër Guatemalës*, Aktgjykimi i IACtHR i datës 4.09.2012, kundërshtimi paraprak, meritat, riparimi dhe kostot, par. 265.

79. Misioni nuk ka dhënë ndonjë shpjegim rreth dështimit për ta mbajtur ankuesen (ose ndonjë të afërm të ngushtë të viktimës së drejtpërdrejt) të informuar në lidhje me këtë rast. Fakti që të dhënat e veta heshtin në lidhje me atë pikë flasin vetë.
80. Kjo dështim kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankuesit për sa i përket shtimit të gjendjes së pasigurisë në të cilën ai e gjeti veten gjatë gjithë periudhës përkatëse.

Dështimi për të hetuar

81. Siç u përmend më lart, qëndrimi i ShM-së është se të gjitha hapat që mund të ndërmerren në mënyrë të arsyeshme për të hetuar këtë rast vërtetë janë ndërmarrë.

ShM-ja gjithashtu deklaroi që pas lirit të pandehurve në maj 2017, Misioni nuk ndërmoi ndonjë hap të mëtutjeshëm hetues sepse "në atë moment, në përputhje me mandatin e tij dhe siç pasqyrohet në legjislacionin në fuqi të Kosovës, në veçanti, Ligji nr. 03/L-053 - i ndryshuar, prokurorët e EULEX-it kishin vetëm autoritet dhe kompetencë për të hetuar 'lëndët që ishin në vazhdim e sipër'. Sipas të njëjtit ligj, kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar raste të tjera nga "rastet që ishin në vazhdim e sipër", mund të nxitet vetëm në "rrethana të jashtëzakonshme" pas një vendimi të përbashkët të EULEX-it dhe autoriteteve kompetente të Kosovës".

82. Misioni gjithashtu sugjeroi që, pasi të kishte hetuar dhe ndjekur një lëndë që kishte të bënte, ndër të tjera, me zhdukjen e babait të ankuesit, "do të ishte e palogjikshme të bënte më shumë përpjekje në këtë rast kur kishte lëndë të tjera në vazhdim e sipër" dhe shprehu mospajtim me sugjerimin për nevojën që të hetohet më tej çështja "pasi kjo mundësi ishte thjesht teorike". Paneli nuk mund të pajtohet me këto parashtresa.
83. Si çështje paraprake, Paneli dëshiron të nxjerrë në pah dallimin midis çështjes së kompetencës për të hetuar dhe asaj të një obligimi për ta bërë këtë. Kompetenca e Misionit për të hetuar krimet që përfshijnë shkeljen e të drejtave të caktuara të njeriut - dhe qëllimin e tyre - është përcaktuar nga një varg ligjesh venfdore, në veçanti, Ligji mbi juridiksionin në përsëritjet e tij të ndryshme. Sa i përket detyrimit të Misionit për t'i hetuar këto, nuk ngritet nga këto dispozita që përcaktojnë kompetencën juridiksionale të prokurorëve të EULEX-it mbi këto raste, por nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (dhe dispozita të ngjashme për të drejtat e njeriut), të cilat mandatojnë Misioni për të garantuar efektivitetin e këtyre të drejtave në kontekstin e funksionit të tij ekzekutiv. Shih p.sh. D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafët 84 etj. Shih gjithashtu, për një ilustrim të zbatimit të këtij nocioni të përgjithshëm: *lënda e Gudiel Alvarez e tutje ("Diario Militar") kundër Guatemalës*, Aktgjykimi i IACtHR i datës 20.11.2012; Meritat, riparimet dhe kostot, në veçanti, paragrafët 192, 231-232.
84. Prandaj, në përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv, Misioni është i detyruar të interpretojë kompetencat e tij - natyrën dhe fushën e tij - në përputhje dhe në një mënyrë konsistente me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Paneli së pari do të shqyrtojë çështjen e kompetencës së Misionit për të hetuar raste të tilla si ato që janë në shqyrtim e sipër.
85. Deri më 15 prill 2014, EULEX-i Kosovë kishte kompetencë të pandërprerë për të hetuar këtë lloj lëndësh (shiko Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it Kosovë, neni 3 dhe Ligji Nr. 03/L-052 në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës). Paneli tashmë ka theksuar në vendimet e kaluara se ky lloj i krimeve - dhe, në të vërtetë, në disa raste, - mund të hetohet si krim lufte ose krim i motivuar etnik. Prandaj, nga fillimi i mandatit të tij deri në prill 2014 (d.m.th., përfshirë periudhën pas lirit nga fajësia, 2007-2014), Misioni ishte me të vërtetë kompetent për të hetuar ose vazhduar hetimin e kësaj lënde.
86. Më 15 Prill 2014, fushëveprimi i kompetencës së prokurorëve të EULEX-it u ngushtua dhe u kufizua në "lëndët që ishin në vazhdim e sipër", d.m.th., raste që ishin hapur nga EULEX-i para kësaj kohe (shiko Ligjin nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve

që lidhen me mandatin e EULEX-it, neni 3.3). Paneli vë në dukje sa vijon në lidhje me periudhën midis prillit 2014 dhe qershor 2018: Së pari, vendimi nëse do të hapet apo jo një lëndë e re është vënë mbi prokurorët e EULEX-it (në bashkëpunim me autoritetet vendore kompetente) ku ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj, vendimi për të mos hapur ose rihapur hetimin e këtij rasti ishte marrë - në mënyrë të hapur apo implicite - nga prokurorët e EULEX-it. Kjo është e qartë edhe nga parashtrimet e Misionit në këtë rast kur ai kërkon të shpjegojë vendimin e tij për të mos hetuar më tej çështjen (shih më poshtë, paragrafi 90). Shih gjithashtu X. dhe 115 Të Tjerët kundër EULEX-it, Lënda nr. 2011-20, Vendimi dhe Gjetjet, 22 prill 2015, paragrafët. 60-67.

87. Së dyti, në përputhje me detyrimet e Misionit në bazë të OPLAN-it, ai detyrim duhet të interpretohet në bazë të detyrimeve të Misionit ndaj të dretave të njeriut. Duke marrë parasysh që shkelja e të drejtave të viktimave dhe e ankuesit ishte duke vazhduar (shih, më lart, paragrafi 64), i ka ra Misionit për të siguruar që ato të drejta të mbroheshin në mënyrë efektive dhe shkelja e tyre të korigjohet siç duhej. Lirimi i atyre që fillimisht u akuzuan për këtë krim nuk i dha fund detyrimit të Misionit në lidhje me këtë. Duke marrë parasysh, veçanërisht, peshën e shkeljes së të drejtave të ankuesit dhe natyrën e vazhdueshme të kësaj shkelje, hetimi i vazhdueshëm i kësaj çështje nuk ishte as "jolicjor" dhe as "teorik", siç kërkon Misioni të portretizojë atë, por një detyrim ligjor i Misioni që u forcua më tej nga pesha e lëndës në fjalë.
88. Për më tepër, Ligji mbi Juridiksionin i zbatueshëm gjatë asaj periudhe (prill 2014-qershor 2018) përmbante një klauzolë me të cilën Misioni mund të ushtronte kompetencë rreth lëndëve (d.m.th, ato që nuk ishin "në vazhdim e sipër" që nga maji 2014) ku ekzistonin "rrethana të jashtëzakonshme". Paneli tashmë ka pasur rastin ta interpretojë këtë nocion. Ai e ka interpretuar atë në një mënyrë që i jep efekt përgjegjësisë së përgjithshme të Misionit për të garantuar mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut në kontekstin e mandatit të tij ekzekutiv. Kështu, në Sadiku-Syla, Paneli tha si vijon:

"ShM-ja pretendon se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi më 17 maj 2014" ka zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e prokurorëve dhe gjykatësve të EULEX-it që të ushtrorin funksione ekzekutive në raste të reja "(Përgjigja, faqja 6, duke iu referuar Ligjit Omnibus që ka ndryshuar Ligjin për juridiksion). Paneli vëren, megjithatë, se neni 7(A) parashikon "Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme": "Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t'i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët të kryeprokurorit të Shtetit dhe EULEX-it KOSOVË si autoritet kompetent. "ShM-ja nuk ka arritur të shpjegojë pse kjo dispozitë nuk do të sigurojë një bazë të përshtatshme juridike mbi të cilën duhet të veprojnë prokurorët e EULEX-it, veçanërisht në një rast të tillë si në këtë lëndë, kur autoritetet vendore nuk duket se janë duke kryer hetime. Paneli do t'i ftojë palët të adresojnë këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtrësia shtesë në lidhje me meritat e kësaj lënde".

Shih Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 29 shtator 2015, para. 62. Shih gjithashtu, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, para. 90; Sadiku-Syla kundër EULEX, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 23 e tutje.

89. Konsideratat që kanë të bëjnë me peshën e veprimeve në fjalë, si dhe natyrën e vazhdueshme të shkeljeve do të ishin konsiderata që lidhen drejtpërdrejt me interpretimin e nocionit të "rrethanave të jashtëzakonshme" në një mënyrë në përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut. Bazuar në këtë, Misioni *mund* të kishte vepruar në përputhje me klauzolën e "rrethanave të jashtëzakonshme" për të hetuar - ose ri-hetuar - këtë rast gjatë periudhës midis qershorit 2014 dhe qershorit 2018. Të dhënat sugjerojnë që Misioni nuk e kishte marrë parasysh këtë mundësi.
90. Përkundrazi, Misioni pohon se kjo do të kishte qenë tepër e rëndë dhe e pajustificuar. Paneli nuk pajtohet. Sigurisht që Misioni ishte i detyruar të bënte zgjedhje në lidhje me rastet që mund të hetonte pasi burimet e tij nuk ishin të pakufizuara. Do të ishte e arsyeshme që prokurorët e EULEX-it të vlerësonin mundësinë e një hetimi të ri që do të *jepte rezultat*. Në vlerësimin e parashtrësës së Misionit, Paneli së pari vëren se Misioni në fakt hetoi dhe ndoqi penalisht këtë lëndë në radhë të parë. Fakti që kjo përfundoi në lirimin e të gjithë të pandehurve nuk është dëshmi e dështimit nga ana e Misionit. As nuk është tregues i dështimit të tij për të mbrojtur të drejtat e ankuesit deri në atë pikë. Përkundrazi, është një tregues i qartë i përpjekjeve të Misionit për të përmbushur mandatin e tij dhe për të përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut.
91. Sidoqoftë, Paneli vëren se lirimi përfundimtar i të pandehurve në vitin 2007 nuk i dha fund detyrimeve të Misionit. Fati i babait të ankuesit nuk ishte vendosur akoma dhe ata që ishin përgjegjës për zhdukjen e tij të sillëshin para drejtësisë. Pra shkelja e të drejtave të ankuesit ishte duke vazhduar, në fakt po vazhdon edhe sot e kësaj dite.
92. Nuk ka asnjë indikacion në shënimet në dispozicion të Panelit që, pas lirimit të vitit 2007, Misioni në të vërtetë diskutoi ose konsideroi mundësinë e kryerjes së hetimit të mëtutjeshëm të kësaj lënde. As nuk ka ndonjë indikacion për ndonjë hetim aktual që po ndodh. Natyra e vazhdueshme e shkeljes së të drejtave të ankuesit dhe rëndësia e këtyre shkeljeve nuk duket se ka shkaktuar ndonjë konsideratë të mundësisë së prokurorëve të EULEX-it që të përdorin kompetencat e tyre "rrethana të jashtëzakonshme" sipas Ligjit të juridiksionit të zbatueshëm pas majit 2014. Paneli vëren se ky mosveprim duhet të vendoset edhe në kontekstin e numrit relativisht të madh të rasteve të tjera "të zhdukjes me forcë", për të cilat Paneli ka dijeni në lidhje me të cilat nuk janë ndërmarrë asnjë ose pak masa hetimore gjatë së njëjtës periudhë. Kjo sugjeron për një dështim shqetësues nga ana e Misionit gjatë asaj periudhe për t'i trajtuar këto raste si përparësi operationale, siç duhej të kishin qenë.
93. Shpejtësia është një element i rëndësishëm këtu. Shpejtësia në hetimin e këtij lloji të lëndëve është parakusht për mbrojtjen efektive të të drejtave të përfshira. Shih, supra, par. 56-57. Shih gjithashtu I kundër EULEX-it, 2013-01, vendimi i 27 nëntorit 2013, par. 15; L.O. kundër EULEX, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015, Dispozicion; Sadiku-Syla kundër EULEX, 2014-34, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016, Dispozicion. Në çdo rast, në veçanti një rast me këtë seriozitet, autoritetet hetimore pritet të veprojnë me shpejtësi të arsyeshme (L.O. kundër EULEX, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015, par. 46).
94. Siç u përmend më lart, kalimi i kohës ka të ngjarë të rezultojë në humbje të dëshmvive dhe kështu minon mundësinë e përcaktimit të fatit të të zhdukurve dhe mundësinë e

sjelljes së autorëve para drejtësisë. Në këtë rast, Misioni nuk duket se ka ndërmarrë ose ka provuar të ndërmarrë ndonjë hap hetimor pas lirimit të të dyshuarve fillestar, duke minuar kështu më tej mundësinë e përcaktimit të fatit të babait të ankuesit dhe ata që janë përgjegjës për zhdukjen e tij duke u ndëshkuar për të. Kalimi i kohës pa lajme për fatin e të zhdukurve kontribuoi gjithashtu në dëm dhe vuajte për të afërmit e mbijetuar të të zhdukurve.

95. Bazuar në atë që u përmend më sipër, pas përfundimit të procedurave gjyqësore në këtë rast, Misioni mbeti kompetent për ishte i obliguar që në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njerut të hetojë këtë lëndë. Ndërsa ka pak dyshime se Misioni bëri të pamundurën për t'i sjellë ata që besohet se ishin përgjegjës për zhdukjen e babait të ankuesit deri në atë pikë, ai më pas u shkëput nga çfarëdo veprimi të mëtejshëm, në kundërshtim me të drejtat e ankuesit. Prandaj, Paneli konstaton se mos veprimi i Misionit të kufizohet në periudhën maj 2017 - qershor 2018.

Mandati i ri, i reduktuar i Misionit që nga qershori 2018

96. Mandati i ri i Misionit, i cili hyri në fuqi në qershor 2018, ka zvogëluar ndjeshëm aftësinë e Misionit për të ndikuar në hetimin e lëndëve penale, duke përfshirë edhe këtë. Roli i tij i ri monitorues nuk e lejon atë të kërkojë fillimin e një hetimi, as nuk i jep atij kompetencë për të vendosur rrjedhën e saj.
97. Në parashtrësat e tij, Misioni gjithashtu ka deklaruar se nuk mund të këshillojë autoritetet e Kosovës në lidhje me çështje të tilla dhe nuk ka asnjë rol në lidhje me rrjedhën e ndonjë hetimi.
98. Përveç nëse është e pakuptimtë, roli "monitorues" i Misionit duhet të lejojë që Misioni të raportojë për dështime të pashpjegueshme, arbitrare ose të pajustificuara nga autoritetet për të përmbushur detyrimet e tyre themelore ndaj të drejtave të njeriut. Hetimi i lëndëve të tilla si ky këtu bie brenda asaj pritjeje themelore. Paneli është i shqetësuar që përveç nëse ai mandat lexohet dhe interpretohet në bazë të detyrimeve gjithpërfshirëse të Misionit ndaj të drejtave të njeriut, aftësia e Misionit për të përmbushur ato detyrime dhe aftësia e tij për të garantuar efektivitetin e të drejtave në fjalë mund të jenë të diskutueshme.
99. Paneli konsideron se ndryshimi në natyrën e mandatit të Misionit nuk e largon Misionin nga detyrimi i tij për të korrigjuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.
100. Në bazë të kësaj, Paneli do të rekomandojë që Misioni duhet të ndërmarrë hapa për të kërkuar nga autoritetet se çfarë hapash, nëse ka pasur, janë duke u ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe për të raportuar tek autoritetet kompetente në Bruksel, nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk po përmbushin detyrimet e tyre në këtë drejtim. Duke dështuar për të mbrojtur të drejtat e ankueses për gati një dekadë, Paneli fuqishëm rekomandon që Misioni duhet të ndërmarrë hapa për të bërë ndryshime dhe korrigjimin e këtyre shkeljeve.

Ekzistimi i një hetimi për këtë rast nga autoritetet vendore

101. Në letrën e tij të datës 17 maj 2019, Misioni tregoi se nuk ishte në dijeni rreth ndonjë hetimi të këtij rasti dhe "ftoj ankuesin dhe Panelin që ta adresoj këtë pyetje tek institucionet kompetente të Kosovës".
102. Paneli së pari vëren se detyrimet ndaj të drejtave të njeriut që rrjedhin nga OPLAN-i janë ato të vetë Misionit, e jo të Panelit. Prandaj, Misioni nuk mund t'u delegojë të tjerëve atë që është përcaktuar të jetë pjesë - dhe pjesa më e rëndësishme – e detyrimeve ligjore të Misionit.
103. Së dyti, Paneli vëren se në lëndën 2017-02, Misioni u mor me këshillimin e autoriteteve të Kosovës për hapa të caktuar hetimor që duhet të ndiqen nga ato autoritete kur ua transferoi dosjen e lëndës atyre. Nga kjo është e qartë se a) nuk ka asnjë ndalësë për Misionin që të këshillojë ose të bëjë rekomandime autoriteteve të Kosovës në lidhje me rrjedhën e mundshme hetimore të veprimit në lidhje me rastet që ishin në mbajtje dhe nën përgjegjësi të Misionit në të kaluarën, dhe që b) aty ku është e përshtatshme, Misioni e ka bërë tashmë atë. Në mënyrë të ngjashme, në 2016-17, gjatë transferimit të dosjes së lëndës tek autoritetet, Misioni në shënimin e transferimit i kishte ftuar autoritetet vendore që të kontaktonin me ta lidhur me hetimin e mundshëm të kësaj lënde.
104. Së treti, autoriteteve që u është dhënë përgjegjësia për të ushtruar disa kompetenca ekzekutive ose gjysmë qeveritare mbi një territor gjatë një periudhe kohore nuk mund t'i kalojnë thjesht detyrimet ndaj të drejtave të njeriut tek autoriteti tjetër në radhë. Kjo është lehtësisht e qartë nga vëzhgimet e Panelit në lidhje me sjelljen e UNMIK-ut. Kjo vlen njëjtë edhe edhe për këtë Mision. Ndërsa roli dhe përgjegjësitë e tij tani janë zvogëluar shumë nën mandatin e tij të ri, kjo nuk mund ta lejojë atë që të shmanget nga përgjegjësitë e veta për dështimet që lidhen me një kohë më të hershme.
105. Bazuar në çfarë u tha më sipër, Paneli do të rekomandojë që Misioni të shqyrtojë me kujdes se çfarë hapash është i lejuar dhe i aftë të ndërmarrë nën mandatin e tij aktual për të siguruar që të kontribuoj në korrigjimin e shkeljeve që i atribuohen, veçanërisht në lidhje me rastet kur shkelja e të drejtave të ankuesit është duke vazhduar.

Pasojat mbi të drejtat e ankueses dhe të drejtat e babait të saj

106. Neni 2 i Konventës mbron një prej të drejtave më themelore të njeriut, përkatësisht të drejtën e jetës. Kjo e drejtë mbrohet nën një larmi instrumentesh për të drejtat e njeriut dhe ajo përbën një element thelbësor, themelor të mbrojtjes minimale të të drejtave të njeriut që i detyrohet çdo individ. Dihet vetëm për disa përjashtime të kufizuara. Shih përgjithësisht Komente të Përgjithshme nr. 36 (2018) në nenin 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, mbi të drejtën e jetës, CCPR/C/GC/36, 30 tetor 2018 (https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_GC_36_8785_E.pdf) (këndeje e tutje, "Komenti i Përgjithshëm 36").
107. Më e rëndësishme për këtë qëllim, kjo e drejtë paraqet një detyrim procedural nga ana e shtetit ose autoritetit kompetent për të hetuar kur ata e dinë apo duhet të kenë pasur

dijeni rreth privimeve potencialisht të paligjshme të jetës, dhe kur është e përshtatshme, për të ndjekur penalisht incidente të tilla, duke përfshirë pohimet e përdorimit të tepruar të forcës me pasoja vdekjeprurëse. Më gjerësisht shih Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi për pranueshmërinë, 29 shtator 2015; shih gjithashtu Nydia Erika Bautista de Arellana kundër Kolumbisë, Komunikimi nr. 563/1993, Pikëpamjet e Komitetit për të Drejtat e Njeriut, 27 tetor 1995 par. 8.6; McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i GjEDNj-së i 27 shtatorit 1995, seria A nr. 324, par. 161; Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 tetor 1998, Raportet e vendimeve dhe vendimeve 1998-VIII, par. 102; Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë, nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 korrik 2005, par. 110; Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 4 maj 2001, par. 105; Komenti i përgjithshëm 36, par. 27; Këshilli për të drejtat e njeriut, Vëzhgime përfundimtare: Kirgistan (2014), par. 13.

108. Hetimet dhe ndjekjet penale të privimeve potencialisht të paligjshme të jetës duhet të ndërmerren në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë *Protokollin Minnesota rreth Hetimeve të Vdekjeve Potencialisht të Paligjshme (2016)*, dhe duhet të synojnë të sigurojnë që përgjegjësit të sillen para drejtësisë, të promovojnë llogaridhënien dhe parandalimin e mosndëshkimit, të shmangin mohimin e drejtësisë dhe të bëjnë të nevojshme mësimet për rishikimin e praktikave dhe politikave me qëllim të shmangies së shkeljeve të përsëritura. Në përgjithësi shih Komentin e përgjithshëm 36, par. 27 dhe referencat e cituara.
109. Gjithashtu relevante për rastin në fjalë është neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili parashih që askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës. Një ndalim dhe garanci e ngjashme është dhënë në shumë instrumente të tjera të të drejtave të njeriut, përfshirë nenin 7 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Kjo është përsëri një e drejtë themelore me rëndësi të madhe që duhet të mbrohet në të gjitha kohërat dhe rrethanat.
110. Është pranuar në jurisprudencën e Panelit dhe në praktikën e organeve të tjera të të drejtave të njeriut se trauma emocionale që mund të rezultojë për të afërmit e një të zhdukuri nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të afërmit të tyre mund të arrijë pragun e seriozitetit që kërkon kjo garanci. Shih, p.sh., L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, vendimet dhe të gjeturat, 11 nëntor 2015; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për Pranueshmëri, 30 Shtator 2015; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim dhe Gjetjet, 19 Tetor 2016. Shih gjithashtu Deklaratën mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me forcë, paragrafi i 5^{të} preambular (duke vënë në dukje se zhdukja me forcë shkakton "ankth dhe vuajtje") dhe (...) përbën një shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare që garantojnë, (...) të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës"); dhe Komenti i përgjithshëm mbi të Drejtën për të Vërtetën në lidhje me Zhdukjet me Forcë, Raportin e Grupit të Punës për Zhdukjet me Forcë, 2010. Dokumenti A/HRC/16/48, par. 4.

111. Sipas mendimit të Panelit, dështimi i Misionit për t'i zbatuar qoftë edhe hapat më themelor hetimor për një kohë të gjatë dhe dështimi i tij për të informuar në mënyrë të duhur ankuesen në lidhje me rrjedhën e hetimit, të gjitha kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas nenit 2 të Konventës për ta hetuar këtë çështje në mënyrë të plotë dhe me zell nga ana e Misionit.
112. Këto dështime dhe lëshime gjithashtu kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas nenit 3 të Konventës dhe ka kontribuar në traumën emocionale dhe psikologjike që kishte rezultuar nga mosdija e asaj që i kishte ndodhur babait të tij. Kjo traumë është e rëndë, konstante dhe e vazhdueshme. Natyrisht nuk është vetëm pasoja e sjelljes së Misionit, mirëpo Paneli nuk është kompetent për të marrë vendime lidhur me përgjegjësinë e UNMIK-ut në këtë drejtim. Sidoqoftë, dështimi i UNMIK-ut, sado serioz, nuk do të justifikonte dështimin e Misionit. Prandaj, gjetjet e bëra këtu janë të kufizuara në ato akte dhe dështime të Misionit që kontribuan në shkeljen e të drejtave të ankuesit dhe të babait të tij, duke marrë parasysh sfidat e lartpërmendura me të cilat Misioni ishte ballafaquar në atë kohë.
113. Megjithatë, Paneli rithekson se Misioni investoi në këtë rast një kohë dhe burime jo të parëndësishme, se këto përpjekje rezultuan në ndjekjen penale të një numri të dyshuarve dhe se këto përpjekje u drejtuan, ndër të tjera, drejt mbrojtjes së të drejtave të ankuesit dhe ato të të afërmeve të tij. Fakti që këto procese nuk kanë arritur të vërtetojnë të vërtetën në lidhje me fatin e të afërmeve të ankuesit nuk duhet t'i atribuohet Misionit. Për më tepër, dështimi hetues i Misionit është relativisht i shkurtër në kohëzgjatje dhe u shfaq në kontekstin e veçantë të "rrethanave të jashtëzakonshme" të parashikuara në Ligjin e atëhershëm në fuqi për Juridiksion. Të gjitha këto konsiderata janë të rëndësishme për të vlerësuar peshën e dështimit të Misionit.
114. Në bazë të konstatimeve të bëra më lart në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës, Paneli nuk mendon se kërkohet që poashtu të arrijë në konkluzione në lidhje me nenin 8 dhe 13 të Konventës. Megjithatë, Paneli vëren se përderisa interesi(interestet) e mbrojtur nga secila dispozitë pjesërisht e mbulojnë të njëjtën gjë, ato nuk janë identike. Për më tepër Paneli thekson se sjellja që i është ngarkuar Misionit duket *prima facie* se ka ndikuar negativisht në të drejtat e ankuesit për jetën familjare dhe të drejtën e tij për një zgjidhje efektive juridike. Paneli nuk do të bëjë gjetje të qarta në lidhje me këto të drejta pasi gjetjet e tij në lidhje me nenet 2 dhe 3 i përfshijnë ato që i konsideron si karakteristika thelbësore të shkeljeve që i janë ngarkuar Misionit.
115. Duke u bazuar në çfarë u cek më sipër, Paneli ka konstatuar se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit dhe babait të tij sipas nenit 2 (pjesa procedurale) dhe nenit 3 të Konventës.

KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

Konstaton se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit dhe babait ytë tij, siç garantohet me nenin 2 (pjesën procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Në bazë të kësaj, Paneli nuk e konsideron të nevojshme të merr vendim në lidhje me shkeljet e mundshme nga Misioni të neneve 8 dhe 13 të Konventës;

Vëren se, në bazë të shënimeve në dispozicion të Panelit, shkelja e së drejtës së ankuesit mund të jetë duke vazhduar; dhe për këtë arsye,

Rekomandon si në vijim:

- i. Duke marrë parasysh rëndësinë e shkeljeve nën shqyrtim, Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranojë shkeljen e ankueses dhe të drejtave të babait të tij të kryer nga Misioni;
- ii. Paneli gjithashtu fton shefin e Misionit të shqyrtojë mundësinë e shprehjes së gatishmërisë së Misionit që të vazhdoj drejt përpjekjeve për të parë që në këtë lëndë drejtësia po vihet në vend;
- iii. Nëse kjo nuk është bërëderi më tani, Paneli fton Misionin të sigurojë që dosja e lëndës që i përket këtij rasti të dërgohet tek autoritetet vendore kompetente;
- iv. Paneli rekomandon që, ashtu siç ndodhi në lëndën 2017-02, Misioni duhet të konsiderojë që të ofroj rekomandime për autoritetet në lidhje me rrugët e mundshme hetimore të ardhshme që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij rasti; në këtë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni të theksojë rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe të informohen për rrjedhën e përgjithshme të hetimit;
- v. Misioni duhet të ndërmarrë hapa aktivë për të kërkuar tek autoritetet se cilat hapa, nëse ka ndonjë, po ndërmerren për të hetuar këtë rast dhe për t'u raportuar autoriteteve kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel, nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk po përmbushin detyrimet në lidhje me këtë;
- vi. Paneli rekomandon që ky vendim t'u ofrohet autoriteteve kompetente hetimore në Kosovë;
- vii. Paneli gjithashtu rekomandon që shefi i Misionit të sigurojë që aktivitetet e monitorimit të Misionit të kryhen në një mënyrë që është në përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe se siguron që kjo pjesë e mandatit të tij të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të këtyre të drejtave.

PANELI PËRGJIGJE KËRKON NGA MISIONI të raportojë mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve sa më shpejt që është e mundur dhe jo më vonë se me datën 11 nëntor 2019; dhe

KËRKON NGA Misioni, që kur të raportoj, të sqarojë se cilat kompetenca "ekzekutive" i gëzon ende në bazë të mandatit aktual.

Për Panelin

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare